



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova



Komuna e Lipjanit



Plani për Mirëmbajtjen  
e Hapësirave të Hapura Publike  
2016- 2020  
Komuna Lipjan

---

# Plani për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike 2016-2020

## Komuna Lipjan

Ndërtimi i qyteteve gjithëpërfshirëse, të shëndetshme, funksionale, atraktive dhe produktive është ndoshta një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet njerëzimi në ditët e sotme. Pjesa më e rëndësishme e enigmës për ta arritur këtë mund të qëndrojë mu në HHP-të të cilat me të drejtë konsiderohen si zemra të zonave urbane.



## Falënderimet

Plani për mirëmbajtjen dhe Plani për investime në hapësirat e hapura publike janë përgatitur nga grupi punues i Komunës së Lipjanit në bashkëpunim të ngushtë me grupin koordinues si dhe me përkrahjen e projektit DEMOS, i cili financohet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe zbatohet nga Helvetas-Swiss Intercooperation (HSI).

### Grupi Punues

1. **Hana Berisha** – Drejtorja për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit  
Kryesuese e grupit
2. **Valzim Mziu** - Drejtorja për Shërbime Publike, anëtar
3. **Rafete Ratkoceri** - Drejtorja për Shërbime Publike, anëtare
4. **Ilir Shala** - Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
5. **Avni Sahiti** – Drejtorja për Inspeksion, anëtar

### Grupi Kordinues

1. **Fitim Selimi** - Nënkyetar i Komunës - kryesues i grupit
2. **Heset Sahiti** - Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar
3. **Shkelzen Hajdini** - Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, anëtar

### Ekipi përkrahës

1. **Bajram Shefkiu** - këshilltar lokal
2. **Teuta Jaha-Hoxha**- zyrtare e projektit DEMOS/HSI-K
3. **Majlinda Jupolli**- zyrtare e projektit DEMOS/HSI-K

## Lista e shkurtesave

<b>HHP</b>	Hapësirat e Hapura Publike
<b>PMHHP</b>	Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike
<b>PIHHP</b>	Plani i Investimeve në Hapësirat e Hapura Publike
<b>DEMOS</b>	Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave
<b>HSI-K</b>	Helvetas Swiss Intercooperation -Kosovë
<b>SCO-K</b>	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë
<b>GIS</b>	Sistemet e Informacionit Gjeografik
<b>KKL</b>	Kuvendi Komunal Lipjan
<b>KL</b>	Komuna Lipjan
<b>PZhK</b>	Plani Zhvillimor Komunal
<b>PZhU</b>	Plani Zhvillimor Urban
<b>PRrU</b>	Plani Rregullues Urban
<b>ZUL</b>	Zona Urbane Lindje
<b>ZUP</b>	Zona Urbane Perëndim
<b>ZUJ</b>	Zona Urbane Jug
<b>ZUQ</b>	Zona Urbane Qendër

# Tabela e përmbajtjes

<b>1. Hyrje.....</b>	<b>7</b>
1.1. Profili i komunës së Lipjanit .....	7
1.2. Funkcionet e HHP-ve.....	8
1.3. Fushëveprimi i Planit të Mirëmbajtjes së HHP-ve .....	8
1.4. Parimet udhëheqëse.....	9
1.5. Dokumentet referuese për hartimin e PMHHP .....	10
<b>2. Gjendja aktuale dhe analiza e HHP-ve .....</b>	<b>11</b>
2.1. Gjendja e tanishme e HHP-ve .....	12
2.2. Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP-ve .....	13
2.3. Cilësia e HHP-ve ekzistuese.....	14
2.4. Shfrytëzimi i HHP-ve ekzistuese .....	14
2.5. Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP-ve.....	15
2.6. Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HHP-ve në tri vitet e kaluara.....	15
2.7. Të dhëna grafike dhe tabelare mbi HHP-të ekzistuese.....	16
2.8. Përshkrime të përgjithshme të aktiviteteve për fusha të ndryshme të mirëmbajtjes .....	19
<b>3. Vizioni, objektivat dhe strategjia mbi HHP-të .....</b>	<b>20</b>
3.1. Vizioni i KK të Lipjanit mbi HHP-të .....	20
3.2. Synimet dhe objektivat specifike .....	20
<b>4. Plani financiar.....</b>	<b>21</b>
4.1. Nevoja për buxhet të ri për mirëmbajtje (të vazhdueshme) .....	22
<b>5. Ndërgjegjësimi publik .....</b>	<b>28</b>
5.1. Strategjia komunale dhe aktivitetet me komunitetin .....	28
<b>6. Monitorimi dhe rishikimi .....</b>	<b>30</b>
6.1. Plotësimi dhe revidimi i PMHHP .....	31
<b>Shtojcat .....</b>	<b>32</b>
Shtojca 1: Hartat tematike.....	32
Shtojca 2: Invetarizimi - Planet e mirëmbajtjes së HHP-ve veç e veç - Format tabelare .....	50
Shtojca 3: Forma e monitorimit të HHP-ve .....	68
Shtojca 4: Përshkrime teknike tipike për mirëmbajtjen e HHP-ve .....	70

## Lista e figurave

Fig. 1: HHP-të në zonën urbane në qendër të qytetit të Lipjanit.....	12
Fig. 2: Paraqitja e HHP-ve sipas frekuencës së shfrytëzimit.....	14
Fig. 3: Përmbledhje – HHP-të sipas sipërfaqeve.....	16
Fig. 4: Raporti i HHP-ve në përqindje.....	17
Fig. 5: Paraqitje grafike - Rekapitulimi i mirëmbajtjes së HHP-ve në euro, për periudhën 2016-2020 .....	19
Fig. 6: Paraqitje grafike - Rekapitulimi i mirëmbajtjes së HHP-ve në përqindje, për periudhën 2016-2020 .....	19
Fig. 7: Kostot e mirëmbajtjes në bazë të kategorive.....	23
Fig. 8: Vlera e mirëmbajtës vjetore.....	25
Fig. 9: Kostot vjetore të mirëmbajtjes.....	25
Fig. 10: Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve .....	26

## Lista e tabelave

Tab. 1: Lista e HHP-ve ekzistuese në qytetin e Lipjanit.....	11
Tab. 2: Oferta aktuale e HHP-ve në qytetin e Lipjanit - Hapësira për rekreacion aktiv dhe pasiv...	13
Tab. 3: Oferta aktuale e HHP-ve në qytetin e Lipjanit - Sipërfaqet e ndërtuara dhe të tjera .....	13
Tab. 4: Oferta aktuale e HHP-ve në qytetin e Lipjanit - Varreza.....	13
Tab. 5: Mirëmbajtja e HHP-ve në periudhën 2012-2013.....	15
Tab. 6: Mirëmbajtja e HHP-ve në periudhën 2014-2016.....	15
Tab. 7: Mirëmbajtja e planifikuar e HHP-ve në periudhën 2016-2020.....	17
Tab. 8: Rekapitulimi i mirëmbajtjes së HHP-ve për periudhën 2016-2020.....	18
Tab. 9: Tabela përmbledhëse e mirëmbajtjes vjetore të HHP-ve .....	22
Tab. 10: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (mujore).....	22
Tab. 11: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (mujore).....	23
Tab. 12: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (tremujore) .....	23
Tab. 13: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (gjysmë-vjetore).....	23
Tab. 14: Mirëmbajtja në baze kategorive kryesore (e shprehur në vlere).....	24
Tab. 15: Mirëmbajtja në baze kategorive kryesore(Sipërfaqet e përllogaritura).....	24
Tab. 16: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (Vlera e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të përllogaritura).....	24
Tab. 17: Kostot vjetore të mirëmbajtës së HHP-ve, e bazuar në muaj .....	25
Tab. 18: Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve (mujore).....	25
Tab. 19: Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve (tremujore). Analiza krahasuese tremujori i parë (baza)-sezonaliteti i përllogaritur .....	26



# 1. HYRJE

Mirëmbajtja e HHP-ve është një nga çështjet kyçe me të cilat në dekadat e fundit përballen të gjitha qeverisjet lokale në Kosovë. Sidoqoftë, aktualisht në shumicën e qyteteve të Kosovës po bëhen përpjekje edhe në fushën e menaxhimit, gjegjësisht mirëmbajtjes së HHP-ve.

I nxitur nga programi DEMOS, i cili financohet nga Qeveria Zvicerane dhe si mbështetje teknike komunave partnere në zhvillimin e tyre është edhe ky Plan i Mirëmbajtjes së HHP-ve. Nga i njëjti pritet përmirësim i gjendjes së përgjithshme të HHP-ve si dhe shfrytëzim racional i tyre por edhe përmirësim në qasjen drejt shërbimeve publike për ambiente tërheqëse dhe të sigurta për qytetarët e komunave partnere të programit.

## 1.1. Profili i komunës së Lipjanit

Lipjani shtrihet në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës dhe besohet se është populluar qysh 6000 vite më parë dhe se ka qenë pjesë përbërëse e qytetit Ilir, Ulpiana, nëpër të cilin kalonin rrugë të rëndësishme tregtare. Zona e Janjevës në shek. XIV – XV njihej si qendër e zhvillimit të minierave. Më 1665, aty është hapur njëra nga shkollat e para në Kosovë.

Sipërfaqja komunale është 338,54 km<sup>2</sup>, ndërsa qyteti (zona urbane), 10,24 km<sup>2</sup>, dhe përfshinë zonat kadastrale: Lipjan, Grackë e Vjetër, Hallaq i Madh, Banullë, Topliqan, dhe Gllgovc.

Janë 62 vendbanime, ndërsa numri i banoreve është 57.605; vetëm në zonën urbane numri i banorëve është 7.364. Dendësia e popullsisë është 170 banorë/km<sup>2</sup>.

Rrugë urbane 66,97 km nga totali i tyre në zonën komunale prej 751 km. Janë 8 parqe dhe sheshe, apo 0,46 ha për kokë banori. Janë 15 hapësira për parkim automjetesh, me 410 vend-parkime. Disa nga objektivat të rëndësishme të dala nga PZhK & PZHU lidhur me HHP-të janë:

- shtimi i hapësirave të gjelbra;
- zhvillimi i korridoreve të gjelbra, bashkë me ndërtimin e rrugëve të reja dhe renovimin e atyre ekzistuese, shtigjeve për këmbësorë, shtigjeve për biçikleta, tamponëve të gjelbërimit tek zonat industriale, tamponëve të gjelbra përgjatë rrugëve në zonat banuese, përgjatë rrugëve me trafik të dendur, etj.;
- reduktimi i intensitetit aktual të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik dhe krijimit të kushteve për lëvizje në këmbë dhe me biçikleta;
- ruajtja e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, etj.;
- konservimi dhe ruajtja e peizazhit dhe zonave natyrore të mbrojtura: Rezervati Blinaja në perëndim, Parku Kulturor-Historik në Kleçkë dhe Divjakë, Shpella e Gadimes, etj.

Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike (PMHHP) është po ashtu një dokument strategjik afatmesëm i bërë në harmoni me planet zhvillimore komunale dhe me ato urbane, si dhe me vendimet dhe rregulloret komunale lidhur me HHP-të.

## 1.2. Funkcionet e HHP-ve

1. Përjetim i natyrës: një mundësi për qytetarët që të përjetojnë mjediset e pasura dhe natyrore, kulturore, arkeologjike, etj.
2. Rekreacion: ofrim i mundësive të llojllojshme për rekreacion në mjedise natyrore; ecje, vrapim, çiklizëm, tubime shoqërore, ngjarje kulturore.
3. Edukim: HHP-të mund të shërbejnë edhe si klasa natyrore me mundësi mësimi dhe hulumtimi me nxënës dhe fëmijë të grupmoshave të ndryshme.
4. Projektim urban: mjediset përgjatë HHP-ve karakterizohen me kufizime në zhvillimet ndërtimore dhe ofrojnë peizazhe dhe pamje të mira, definojnë kufijtë urban, si dhe dekurajojnë zgjerimet e pakontrolluara urbane.
5. Krijim i trashëgimisë: ruajtja e tipareve të rëndësishme të mjedisit natyror të qytetit të Lipjanit është prioritet i lartë për qytetarët dhe për ambiciet programore lidhur me shtretërit e lumenjve, korridoret e gjelbra, ato hekurudhore, rrugore, etj.
6. Organizime kulturore: edukim i publikut për ruajtjen e natyrës, ambientit dhe ngritjen e ndërgjegjes qytetare.
7. Funksione rregulluese klimatike: ruajtja e llojllojshmërisë së florës dhe faunës, balancim i CO<sup>2</sup>, motivim dhe inspirim për kulturë, art, etj.

## 1.3. Fushëveprimi i Planit të Mirëmbajtjes së HHP-ve

Me Hapësira të Hapura Publike (HHP) të përfshira në këtë plan, nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rëndësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytetin e Lipjanit si: parqet, sheshet, hapësirat për parkim automjesh, trotualet, varrezat dhe hapësirat përreth objekteve sakrale dhe monumentale, përfshirë ndriçimin publik brenda tyre.

Qëllimi i Planit të Mirëmbajtjes (PM) është që qartas të definojë nevojat/kërkesat dhe veprimet e qeverisjes lokale dhe drejtorive gjegjëse komunale për t'i mirëmbajtur HHP-të në një nivel standard të dëshirueshëm. Ai është i menduar që të mundësojë identifikimin, justifikimin dhe definimin e prioriteteve të nevojshme për mirëmbajtjen e HHP-ve dhe pasurive të tjera të gjendura në to.

Plani është i hartuar për periudhën afatmesme 2016-2020, është i revidueshëm dhe mund të plotësohet e të përditësohet për çdo vit dhe në baza empirike pas analizës së realizimit të tij në vitin paraprak.

## 1.4. Parimet udhëheqëse

Këtu me poshtë janë përmendur disa nga parimet udhëheqëse për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e HHP-ve si procese ligjore dhe të planifikimit të komunitetit, bazuar në strategjinë mbi HHP-të si pjesë vitale e kornizës së zhvillimit lokal me qëllim të përmirësimit dhe ruajtjes së karakterit të hapësirave në të cilat qytetarët jetojnë, veprojnë dhe kalojnë kohën e tyre të lirë:

1. Mirëmbajtja e të gjitha HHP-ve në gjendje të mire dhe funksionale;
2. Shpërndarja e njëtrajtshme e HHP-ve në të gjitha vendbanimet, qofshin ato formale apo joformale;
3. Adresimi i drejtë i të gjitha çështjeve projektuese dhe operative lidhur me nevojat për mirëmbajtjen e HHP-ve;
4. Standardizimi i mirëmbajtjes së rregullt. Në të ardhmen e afërt, mund pritët që të vendoset një sistem relativisht i normalizuar dhe i njëjti të adaptohet qoftë për planifikim, për rishikim të kërkesave plotësuese në mirëmbajtje apo për zhvillimin e hapësirave të reja publike.

Zonat/fushat e mirëmbajtjes së HHP-ve të rekomanduara për standardizim në këtë dhe në dokumentet e përditësuara deri në normalizimin e pritët gjatë cikleve të ardhshme të projektit janë:

1. Mirëmbajtja e gjelbërimit (të ulët, të mesëm, të lartë);
2. Mirëmbajtja e ambienteve të ndërtuara (sheshe, shtigje për këmbësorë dhe sipërfaqe të shtruara);
3. Mirëmbajtja e hapësirave për parkim automjesh;
4. Mirëmbajtja e rrethojave të HHP-ve;
5. Mirëmbajtja e ndriçimit publik në kuadër të HHP-ve
6. Mirëmbajtja e varrezave.

Përshkrime standarde në formë të specifikimeve teknike për fusha të ndryshme të mirëmbajtjes së HHP-ve janë pjesë përbërëse e këtij dokumenti (Shtojca 4).

Për shkak të gjendjes aktuale jo të mirë, planifikimi për shpenzime kapitale të nevojshme për revitalizim është i përfshirë në Planin e investimeve në hapësira të hapura publike (PIHHP) dhe i njëjti është përpiluar pas incizimit në detaje të gjendjes aktuale të HHP-ve në qytet.

## 1.5. Dokumentet referuese për hartimin e PMHHP

**Disa nga dokumentet në kuadër të kornizës ligjore, në të cilat është referuar përgatitja e këtij plani janë:**

1. Plani Zhvillimor Komunal, 2013-2023;
2. Plani Zhvillimor Urban, 2013-2018;
3. Planet Rregulluese Urbane, të vitit 2010;
4. Rregullore komunale për shërbime publike;
5. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e RK / Prishtinë: viti III / Nr. 28 / 04 qershor 2008, Neni 17, paragrafi p, ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike;
6. Ligji për Planifikim Hapësinor (Ligji Nr. 04/L-174, 31 korrik 2013);
7. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Ligji Nr. 03/L-025, 26 shkurt 2009);
8. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2005-2007, mars 2005, e mbështetur nga World Bank Group, LGI dhe RIINVEST, dhe Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2012-2017;
9. Ligji për ujërat e Kosovës;
10. Ligji për mbeturinat;
11. Ligji për mbrojtjen e natyrës;
12. Ligji për pyjet e Kosovës.

Në kapitullin V të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal, "Vizioni dhe Projektet", parashihet Lipjani me zhvillim të lartë ekonomik, industrial, zhvillim ekologjik dhe të turizmit në përputhje me standardet moderne, me kushte atraktive për jetese dhe për investime.

Ndërsa në kapitullin VII, në kuadër të synimeve përmenden edhe projekte si: Plani Zhvillimor Strategjik 2004-2005, incizimi i kadastrit nëntokësor, krijimi i bazës së shënimeve për pronat komunale dhe për hapësirat industriale, projekti i bulevardit "Lidhja e Prizrenit" dhe ndërtimi i rrethrotullimeve në qendër të qytetit, rregullimi i hapësirave të lira në zonën e qendrës dhe sipas PZhU, rregullimi dhe mirëmbajtja e shtratit të lumit Sitnica, mbrojtja nga vërshimet, etj.

Në kapitullin III të PZhK, tek Trashëgimia Natyrore, strategjia 3, përshihet përmirësimi i cilësisë së hapësirave të gjelbra, rritja e numrit të parqeve dhe hapësirave të gjelbra në vendbanimet me dendësi banimi dhe krijimi i parkut të ri në qytetin e Lipjanit.

Në kapitullin IV të po të njëjtit plan, parashihet hartimi i projekteve të parapara me këtë plan, për rritjen e sipërfaqeve të gjelbra në qytet dhe në vendbanimet tjera nëpërmjet ri-trajtit të hapësirave aktualisht të lira ose të pashfrytëzuara, si dhe krijimit të zonave të gjelbra të reja brenda dhe përreth qytetit dhe vendbanimeve tjera.

Tek PZhU, kreu 7, pika 7.1.6, Natyra dhe Peizazhi, dhe në atë 7.2.1, Masat për Mbrojtjen e Peizazhit, Vlerave Natyrore dhe Tërësive Kulturo-Historike, theks i veçantë i kushtohet hapësirave gjelbëruese përgjatë shtratit të lumit Sitnica, të cilat pretendohet të integrohen në HHP në qendrën aktuale të qytetit.

## 2. GJENDJA AKTUALE DHE ANALIZA E HHP-VE

Në tabelën 1 është dhënë lista e të gjitha HHP-ve ekzistuese, e dalë nga inventarizimi i përmendur sipas tipologjisë, me emrin apo lokacionin, me atributet siç është syprina e sipërfaqes, gjendja aktuale dhe pronësia.

Tab. 1: Lista e HHP-ve ekzistuese në qytetin e Lipjanit

Nr.	Tipologjia dhe emri / lokacioni i HHP	Kodi i HHP	Sip. në m <sup>2</sup>	Gjendja aktuale	Pronësia
1	Parku tek sh. f. "Vëll. Frashëri"	HHP-1_D	2.698	jo e mirë	Komunale
2	Parku tek Hekurudha	HHP-2_J2	2.385	jo e mirë	Komunale
3	Parku pas ndërtesës së KKL	HHP-3_G1	1.994	jo e mirë	Komunale
4	Parku tek Shtëpia e Kulturës	HHP-4_ZUP 1	1.672	jo e mirë	Komunale
5	Parku tek banesat e vjetra	HHP-5_F	876	mesatare	Komunale
6	Parku tek Çerdhja e fëmijëve	HHP-6_F1	1.741	mesatare	Komunale
7	Gjelbërimi tek Shtëpia e Kulturës	HHP-16&17_ZUP-1	2.817	mesatare	Komunale
8	Parku pas Hekurudhës	HHP-18_J2	4.422	jo e mirë	Komunale
9	Parku në ZUP	HHP-23_ZUP8	11.841	jo e mirë	Komunale
10	Shesh	HHP-25&26	6.000	jo e mirë	Komunale
11	Terren sportiv	HHP-20_ZUL 5	8.487	jo e mirë	Komunale
12	Vendparkimi pas ndërtesës së KKL	HHP-8 & 9_G1	5.638,90	mesatare	Komunale
13	Vendparkimi tek Çerdhja e Fëmijëve	HHP-10_F1	4.445,41	mesatare	Komunale
14	Vendparkimi pas objektit të postës	HHP-11_F3	4.484,88	mesatare	Komunale
15	Vendparkimi tek Shtëpia e Kulturës	HHP-12_ZUP 1	3.603,06	jo e mirë	Komunale
16	Vendparkimi tek banesat e vjetra	HHP-13_ZU QEND.	4.487,28	mesatare	Komunale
17	Tregu i qytetit	HHP-21_B	5.078	mesatare	Komunale
18	Trotuari tek rruga "Lidhja e Prizrenit"	HHP-27_TR-LP	9.900	mesatare	Komunale
19	Trotuari tek rruga "Skënderbeu"	HHP28_TR-SK	4.500	mesatare	Komunale
20	Trotuari tek rruga "Skënderbeu"	HHP29_TR-SK	5.472	mesatare	Komunale
21	Varrezat myslimane	HHP-22_ZUP 4	19.362	mesatare	Komunale
22	Varrezat krishtere	HHP24_ZUL8	13.574	mesatare	Komunale
Gjithsej HHP			125.476,53		

Ndërsa në figurën 1 është paraqitur një pjesë e hartës së qytetit, zona e ngushtë e qendrës ku HHP-të ekzistuese kryesisht janë të grupuara.



Fig. 1: HHP-të në zonën urbane në qendër të qytetit të Lipjanit

## 2.1. Gjendja e tanishme e HHP-ve

Një inspektim në detaje është ndërmarrë nga ana e grupit punues për ta evidentuar dhe përditësuar inventarin e HHP-ve, për t'i matur sipërfaqet, si dhe për ta vlerësuar gjendjen aktuale të tyre në qytetin e Lipjanit. Kjo ishte faza e parë e vlerësimit sistematik, promovimit dhe zhvillimit të PMHHP në zonën urbane të qytetit.

Rezultatet e këtij inventarizimi në detaje janë paraqitur në hartat tematike të krijuara në aplikacionin QGIS si dhe në formë tabelore (shtojca 1 dhe ajo 2 në këtë dokument), të punuara gjatë seancave të rregullta me këshilltarët e programit DEMOS. Në të njëjtat janë paraqitur HHP-të me atributet sipas tipologjisë, madhësisë, kualitetit, si dhe sipas frekuentimit nga ana e qytetarëve.

Disa nga planet dhe projektet e përmendura si hartimi i PZhK, i PZhU, projekti i bulevardit “Lidhja e Prizrenit” përfshirë rrethotullimet, veçse janë realizuar, përderisa të tjera si ato lidhur me zhvillimin e HHP-ve përgjatë lumit Sitnica dhe ndërlidhja me HHP-të në zonën e qendrës, rindërtimi i sheshit “Adem Jashari” etj., në mungesë të fondeve, edhe më tej mbeten vetëm plane afatgjate të KKL.

Mirëmbajtja rutinore e lumit Sitnica gjithashtu për arsye të njëjta ende nuk është përfshirë në planet aktuale dhe aplikohet vetëm në situata të caktuara si masë për mbrojtjen nga vërshimet.

## 2.2. Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP-ve

Për ta pasur një ide të ofertës aktuale të HHP-ve në qytetin e Lipjanit, nga inventarizimi i përmendur janë marre të dhëna mbi sipërfaqet e hapësirave për kokë banori, të cilat janë treguar në tabelën 2.

Tab. 2: Oferta aktuale e HHP-ve në qytetin e Lipjanit - Hapësira për rekreacion aktiv dhe pasiv

HHP-të sipas tipologjisë	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>	Nr. i banorëve	Sip. e HHP-ve në m <sup>2</sup> / ban.
Parqe/gjelbërime	30.446	7.364	4,13
Sheshe	3.986	7.364	0,54
Terrene sportive	8.487	7.364	1,15
Gjithsej HHP në m <sup>2</sup>	42.919	7.364	5,82

Tab. 3: Oferta aktuale e HHP-ve në qytetin e Lipjanit - Sipërfaqet e ndërtuara dhe të tjera

HHP-të sipas tipologjisë	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>	Nr. i banorëve	Sip. e HHP-ve në m <sup>2</sup> / ban.
Parkingje	12.652	7.364	1,72
Tregje të gjelbra	5.078	7.364	0,69
Trotuare	19.872	7.364	2,70
Gjithsej HHP në m <sup>2</sup>	37.602	7.364	5,11

Tab. 4: Oferta aktuale e HHP-ve në qytetin e Lipjanit - Varreza

HHP-të sipas tipologjisë	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>	Nr. i banorëve	Sip. e HHP-ve në m <sup>2</sup> / ban.
Varreza	32.936	7.364	4,47

Nga tabelat më lart, është evidente se standardet lokale ekzistuese nuk përkojnë me ato projektuese dhe të synuara për HHP (sheshe, parqe dhe rekreacion), ndërsa gjendja e tanishme në përgjithësi mund të përshkruhet si në vijim:

1. Sipërfaqja aktuale e HHP-ve për rekreacion aktiv dhe pasiv është 5,82 m<sup>2</sup>/ban. (tab. 2).
2. Oferta aktuale në aspektin e qasjes, me fokus në largësinë (distanca – kohë); Megjithatë ende nuk është kryer ndonjë analizë në aspektin e rrezes së mbulimit me HHP, nga vërtetimet e përgjithshme është e qartë se hapësirat ekzistuese në përgjithësi janë të koncentruara në qendër. Ato nuk mbulojnë zonat urbane larg qendrës së qytetit.
3. Për momentin nuk mund të pohohet se ato vërtetë janë të mjaftueshme dhe të ndërlidhura mirë, mirëpo është synim i Komunës së Lipjanit që në një plan afatgjatë të ofrojë të njëjtat në një nivel standard të dëshirueshëm.

Standardet e synuara/të parapara në planet komunale janë adaptuar edhe në PMHHP; Qeveria komunale synon të ofrojë HHP për rekreacion aktiv dhe pasiv në numër dhe sasi të mjaftueshme për t'i plotësuar nevojat me përmbajtje natyrore, sheshe, shtigje, hapësira të tjera të shpërndara në aspektin hapësinor ashtu që ato të jenë afër qytetareve. Standardi i synuar kuantitativ i HHP-ve në plan afatgjatë është 10 m<sup>2</sup>/ban.

## 2.3. Cilësia e HHP-ve ekzistuese

Standardet kualitative; HHP-të kualitative promovojnë ruajtjen e shëndetit fizik dhe mendor. Mundësia për aktivitete fizike, qofshin ato aktive apo pasive, për pjesëmarrësit do të jetë e dobishme si në aspektin fizik, shoqëror dhe psikologjik, duke rezultuar në reduktim të tensionit/stresit të përditshëm, në promovimin e jetës së shëndoshë të qytetarëve si dhe në stabilitetin e lagjeve.

Është vlerësim i përgjithshëm se në mungesë të një plani adekuat por edhe për shkak të kapaciteteve buxhetore të kufizuara, HHP-të në të kaluarën nuk janë mirëmbajtur në nivel të duhur.

## 2.4. Shfrytëzimi i HHP-ve ekzistuese

Sipas përdorimit, HHP-të në përgjithësi janë klasifikuar në ato me përdorim të shpeshtë, siç janë parqet dhe hapësirat gjelbëruese në zonën e ngushtë të qendrës; me shfrytëzim mesatar; dhe HHP të cilat nuk përdoren fare. Në këto të fundit hyjnë hapësirat gjelbëruese tek hekurudha, tek kisha dhe ajo tek stacioni i autobusëve në të cilat do të investohet gjatë periudhës së realizimit të këtij plani.



Fig. 2: Paraqitja e HHP-ve sipas frekuencës së shfrytëzimit

## 2.5. Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP-ve

Në të kaluarën si edhe tani, mirëmbajtja e HHP-ve është bërë me kontrata shërbimesh të dhëna operatorëve të kontraktuar nga jashtë, gjegjësisht, kontrata kornizë me afat trevjeçar. Të njëjtat menaxhohen nga zyrtari i angazhuar për mbikëqyrjen e projekteve të infrastrukturës. Nga defektet e shumta të identifikuara në to, mund të përmenden:

- a. mangësi në ndarjen e zonave/fushave të mirëmbajtjes;
- b. mangësi në aktivitetet e parapara të mirëmbajtjes;
- c. përshkrime të pasakta të aktiviteteve të mirëmbajtjes;
- d. mungesë e specifikimeve teknike;
- e. mangësi në planifikim dhe në dinamikë të mirëmbajtjes, etj.

Mangësitë e përmendura më lart kane vënë në pikëpyetje edhe relevancën e çmimeve të ofertuara në kontratat e mëhershme, ndërsa si pasojë edhe monitorimi i mirëmbajtjes ka mund të jetë i vështirësuar.

## 2.6. Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HHP-ve në tri vitet e kaluara

Nga analiza e kontratave të mëhershme, në tabelën në vijim janë paraqitur të dhëna mbi çmimet për njësi dhe për mirëmbajtjen e HHP-ve:

Tab. 5: Mirëmbajtja e HHP-ve në periudhën 2012-2013

HHP-të sipas tipologjisë	Njësia / m <sup>2</sup>	Çmimi njësi mes. €/m <sup>2</sup>	Çmimi i mirëmbajtjes së HHP-ve/ totali në €
Parqe/gjelbërime	9.375	0,78	7.349
Parkingje	3.282	0,444	1.458
Gjithsej për mirëmbajtjen e HHP-ve	12.657	0,70	8.807

\*) Sheshet e përfshira në kuadër të kontratës për mirëmbajtjen e rrugëve; tregjet e mirëmbajtura nga shfrytëzuesit e hapësirave, ndërsa varrezat nuk janë mirëmbajtur fare.

Tab. 6: Mirëmbajtja e HHP-ve në periudhën 2014-2016

HHP-të sipas tipologjisë	Njësia / m <sup>2</sup>	Çmimi njësi mes. €/m <sup>2</sup>	Çmimi i mirëmbajtjes së HHP-ve /totali në €
Parqe/gjelbërime	18.100	0,11	1.972
Parkingje	6.729	0,09	590
Gjithsej për mirëmbajtjen e HHP-ve	24.829	0,103	2.562

\*)Sheshet janë të përfshira në kuadër të kontratës për mirëmbajtjen e rrugëve; tregjet e mirëmbajtura nga shfrytëzuesit e hapësirave, ndërsa varrezat nuk janë mirëmbajtur fare.

## 2.7. Të dhëna grafike dhe tabelare mbi HHP-të ekzistuese

Në vijim është paraqitur një përmbledhje mbi raportin e sipërfaqeve të HHP-ve sipas tipologjive:






Fig. 3: Përmbledhje – HHP-të sipas sipërfaqeve

### Raporti i sip. të HHP në përqindje


■ Parqe ■ Sheshe ■ Ter. Sport ■ Parkingje  
 ■ Tregje ■ Trotuare ■ Varreza




#### 1. Parqet




#### 2. Parkingjet



#### 3. Sheshe



#### 4. Terrene Sportive



## 5. Tregje




Fig. 4: Raporti i HHP-ve në përqindje

\*\*) Sqarimet për kodet / shkurtesat në emërimin e HHP-ve janë dhënë në tab. 1 në fillim të këtij kapitulli

Të dhënat tabelare nga planifikimi i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike (HHP) për tipologjitë e caktuara në periudhën afatmesme 2016-2020 janë dhënë në tab. 7, nga 1 deri në 7.

Tab. 7: Mirëmbajtja e planifikuar e HHP-ve në periudhën 2016-2020

7.1 Parqet				
Nr.	Kodi i HHP	Sip. në m <sup>2</sup>	Totali për mirëmb. në €	Çmimi në € për m <sup>2</sup> <sup>1</sup>
1	HHP-1_D	2.698	5.239,47	1,94
2	HHP-2_J2	2.385	5.125,63	2,15
3	HHP-3_G1	1.994	4.503,55	2,26
4	HHP-4_ZUP 1	1.672	3.381,80	2,02
5	HHP-5_F	876	1.903,95	2,17
6	HHP-6_F1	1.741	3.596,23	2,07
7	HHP-16&17_ZUP-1	2.817	5.229,77	1,86
8	HHP-18_J2	4.422	8.077,82	1,83
9	HHP-23_ZUP8	11.841	6.469,14	0,55
	Gjithsej	30.446	43.527,36	1,43

7.2 Sheshe				
Nr.	Kodi i HHP	Sip. në m <sup>2</sup>	Totali për mirëmb. në €	Çmimi në € për m <sup>2</sup>
1	HHP-25&26_Sheshi	6.000	6.262,00	1,04

7.3 Terrene sportive				
Nr.	Kodi i HHP	Sip. në m <sup>2</sup>	Totali për mirëmb. në €	Çmimi në € për m <sup>2</sup>
1	HHP-20_ZUL 5	8.487	5.108,61	0,60

1 Qmimi njësi është i rrumbullakësuar

7.4 Parkingje				
Nr.	Kodi i HHP	Sip. në m <sup>2</sup>	Totali për mirëmb. në € <sup>2</sup>	Çmimi në € për m <sup>2 2</sup>
1	HHP-8 & 9_G1	3.356	5.638,90	1,68
2	HHP-10_F1	2.351	4.445,41	1,89
3	HHP-11_F3	2.536	4.484,88	1,77
4	HHP-12_ZUP 1	1.987	3.603,06	1,81
5	HHP-13_ZU QENDRA	2.422	4.487,28	1,85
	Gjithsej	12.652	22.659,53	1,79

7.5 Tregje				
Nr.	Kodi i HHP	Sip. në m <sup>2</sup>	Totali për mirëmb. në €	Çmimi në € për m <sup>2</sup>
1	HHP-21_B	5.078	4.108,62	0,81

7.6 Trotuare				
Nr.	Kodi i HHP	Sip. në m <sup>2</sup>	Totali për mirëmb. në €	çmimi në € për m <sup>2</sup>
1	HHP-27_TR-LP	9.900	9.336,00	0,94
2	HHP28_TR-SK	4.500	5.886,80	1,31
3	HHP29_TR-SK	5.472	11.014,50	2,01
	Gjithsej	19.872	26.237,30	1,32

7.7 Varrezat				
Nr.	Kodi i HHP	Sip. në m <sup>2</sup>	Totali për mirëmb. në €	Çmimi në € për m <sup>2</sup>
1	HHP-22_ZUP 4	19.362	4.534,26	0,23
2	HHP24_ZUL8	13.574	3.213,02	0,24
	Gjithsej	32.936	7.747,28	0,24

Tab. 8: Rekapitulimi i mirëmbajtjes së HHP-ve për periudhën 2016-2020

Tabela përmbledhëse e HHP-ve sipas tipologjisë dhe mirëmbajtja e paraparë vjetore				
Nr.	HHP sipas tipologjisë	Sip. në m <sup>2</sup>	Totali për mirëmbajtjen në €	Çmimi në € për m <sup>2</sup>
1	Parqe	30.446,00	43.527,36	1,43
2	Sheshe	6.000	6.262,00	1,04
3	Terrene sportive	8.487,00	5.108,61	0,60
4	Parkingje	12.652,00	22.659,53	1,79
5	Tregje	5.078,00	4.108,62	0,81
6	Trotuare	19.872	26.237,30	1,32
7	Varreza	32.936,00	7.747,28	0,24
	Gjithsej HHP	115.471,00	115.650,70	1,00

2 Çmimi njësi është i rumbullakësuar




Fig. 5: Paraqitje grafike - Rekapitulimi i mirëmbajtjes së HHP-ve në euro, për periudhën 2016-2020

#### Raporti i mirëmbajtjes së HHP në përqindje




Fig. 6: Paraqitje grafike - Rekapitulimi i mirëmbajtjes së HHP-ve në përqindje, për periudhën 2016-2020

## 2.8. Përshkrime të përgjithshme të aktiviteteve për fusha të ndryshme të mirëmbajtjes

- Në aktivitetet e pastrimit përfshihen: grumbullimi dhe largimi i mbeturinave, gjetheve, pastrimi i kanaleve të kullimit, pastrimin e grafitëve, i shtigjeve dhe sipërfaqeve të ndërtuara (me kubëza betoni, asfalt, beton, fontana dhe vepra arti, etj.).
- Në aktivitetet e hortikulturës përfshihen: ujitja, kositja, mbjellja, plehërimi, ajrosja, dezinfektimi, mirëmbajtja e gjelbërimit të ulët, të mesëm, të lartë, etj.
- Në aktivitetet e mirëmbajtjes së ambientit të ndërtuar në kuadër të HHP-ve siç janë: mirëmbajtje/riparime të vogla në shtigje, sipërfaqe të ndërtuara, mobileri urbane, kënde për lojëra fëmijësh, fontana, sisteme të ujitjes, mirëmbajtje për skulptura dhe vepra të tjera arti, mirëmbajtje e ndriçimit publik, etj.

## 3. VIZIONI, OBJEKTIVAT DHE STRATEGJIA MBI HHP-TË

### 3.1. Vizioni i KK të Lipjanit mbi HHP-të

Vizioni për qytetin e Lipjanit është i përcaktuar në Planet Zhvillimore Komunale dhe Urbane si dhe në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal e që është: *“Qendër me vlera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe sigurim i ambientit të qëndrueshëm urban”*.

Në mënyrë që të ofrojë vizionin për HHP-të në qytetin e Lipjanit, grupi punues në konsultim me grupin koordinues ka zhvilluar objektivat e përgjithshme në vijim:

1. Të ofrojë hapësira publike me qasje të mirë, të ndërlidhura mirë, shumë funksionale dhe të dalueshme/identifikuese.
2. Të menaxhojë me kualitetin e HHP-ve në mënyrë që të sigurojë që ato të jenë tërheqëse dhe të sigurta për të gjithë shfrytëzuesit.
3. Të mbështesë dhe të promovojë në mënyrë aktive partneritetin publiko privat dhe përfshirjen e komunitetit. Mbështetja dhe partneriteti si nga aspekti i vetëdijesimit, ruajtja e HHP-ve ashtu edhe sa i përket pjesëmarrjes aktive dhe konsultimit me qytetarë në planifikim të HHP-ve të reja në përputhshmëri me nevojat e komunitetit – (kërkesë nga debati publik i mbajtur me 8 dhjetor 2015).

### 3.2. Synimet dhe objektivat specifike

#### Synimi 1 – Ngritja e cilësisë së HHP-ve ekzistuese

- **Objektivi 1:** Ngritja e nivelit të mirëmbajtjes dhe përmirësimi i cilësisë së HHP-ve në periudhën afatmesme 2016 – 2020 nëpërmjet zbatimit të planit të hartuar.

#### Synimi 2 – Promovimi i HHP-ve

- **Objektivi 1:** Sensibilizimi i komunitetit për mirëmbajtjen e HHP-ve në periudhën afatmesme 2016 - 2020.

#### Synimi 3 - Revitalizimi i HHP-ve ekzistuese

- **Objektivi 1:** Deri në fund të vitit 2016, të revitalizohen 8.746,00 m<sup>2</sup> parqe ekzistuese.
- **Objektivi 2:** Deri në fund të vitit 2017, të revitalizohen 10.710,00 m<sup>2</sup> parqe ekzistuese.
- **Objektivi 3:** Deri në vitin 2020, të revitalizohen 9.900,00 m<sup>2</sup> parkingje ekzistuese.
- **Objektivi 4:** Deri në vitin 2020 të revitalizohen rreth 18.000 m<sup>2</sup> parqe dhe hapësira gjelbëruese.
- Rehabilitimi dhe rindërtimi i sheshit “Adem Jashari”, hapësire ekzistuese prej 6.000 m<sup>2</sup>.

#### Synimi 4 - Investimet në HHP-të e reja

- **Objektivi 1:** Deri në vitin 2020, do të krijohen korridore të gjelbra me rreth 1300 trupa drunjë të mbjellë përgjatë trotuareve dhe hapësirave përreth.
- **Objektivi 2:** Krijimi i HHP-ve të reja me sipërfaqe rreth 14.000 m<sup>2</sup> deri në vitin 2018 të cilat do të kontribuonin në rritjen e standardit sasior me 1,84 m<sup>2</sup>/ban.;
  - Parku tek ETC (ZUP1) me 10.011,00 m<sup>2</sup>, dhe
  - Parku tek kisha (HHP-B) me 3.544 m<sup>2</sup>,
- **Objektivi 3:** Deri në fund të vitit 2020, rindërtimi i sheshit “Adem Jashari” me sipërfaqe prej 6.000 m<sup>2</sup>.

## 4. PLANI FINANCIAR

Plani vjetor i mirëmbajtjes është i bazuar në buxhetet aktuale të KK të Lipjanit për krijimin e mundësisë që të ofrohet cilësi në nivel të kënaqshëm tek HHP-të. Pikënisja e planit financiar është të mundësohet mbulimi i kostove të mirëmbajtjes për aktivitetet e planifikuara vjetore të mirëmbajtjes. Plani i mirëmbajtjes për periudhën 2016-2020 përfshinë të gjitha hapësirat publike ekzistuese po ashtu edhe të gjitha kostot e mirëmbajtjes së HHP-ve të cilat do të ndërtohen ose investimet e reja në hapësirat si pjesë e planit investiv për periudhën e planit. Hapësirat e reja të investuara do të përfshihen në planin e mirëmbajtjes në periudhën e planifikuar.

### Hapësirat e hapura publike në vitin 2015 përbëjnë:

- Sipërfaqet e HHP-ve aktuale përbëjnë 115.471,00 m<sup>2</sup>;
- Numri i hapësirave të hapura publike është 22;
- Vlera e përlogaritur e kostove vjetore e hapësirave të mirëmbajtura është 115.698,24 euro;
- Vlera mesatare mujore e kostove të mirëmbajtjes është 9,958 euro;
- **Ambienti i ndërtuar** - kostoja e mirëmbajtjes është në vlerë prej 69.652 euro (50,1% prej totalit të kostove vjetore);
- **Aktivitetet e Pastrimit** - kostoja e mirëmbajtjes është në vlerë prej 28.103 euro (40,2% prej totalit të kostove vjetore);
- **Aktivitetet e Hortikulturës** - kostoja e mirëmbajtjes është në vlerë prej 21.626 euro (28,4% prej totalit të kostove vjetore).

## 4.1. Nevoja për buxhet të ri për mirëmbajtje (të vazhdueshme) (e cila do të zhvillohet së bashku me buxhetin e ri për investime në HHP)

Tab. 9: Tabela përmbledhëse e mirëmbajtjes vjetore të HHP-ve

<b>Numri i hapësirave</b>	22
<b>Vlera e vjetore e mirëmbajtjes</b>	115.698,24 euro
<b>Vlera e mesatare mujore e mirëmbajtjes</b>	9.641,52 euro

Ndarja e mirëmbajtjes në kategori	Euro	Euro/ %	m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup> /%
Trotuare	26.237	22,7%	29.074	8,9%
Parkingje	22.660	19,6%	26.937	8,3%
Parqe	43.527	37,6%	138.447	42,5%
Varreza	7.747	6,7%	98.808	30,3%
Fusha sportive	5.109	4,4%	15.245	4,7%
Sheshe	6.262	5,4%	7.156	2,2%
Tregje	4.156	3,6%	10.207	3,1%
<b>Totali</b>	<b>115.698</b>	<b>100,0%</b>	<b>325,874</b>	<b>100,0%</b>

Sipërfaqeve të mirëmbajtura	EUR	m <sup>2</sup>	euro/m <sup>2</sup>	Janar-Qershor 2016	Korrik-Dhjetor 2016	Janar-Qershor 2016	Korrik-Dhjetor 2016
AN-Ambienti i ndërtuar	73.385	148.995	0,49	37.271	36.113	50,8%	49,2%
CA - Cleaning activities	25.243	175.722	0,14	14.362	10.881	56,9%	43,1%
H- Horticultural activities	17.070	1.157	14,75	15.474	1.597	90,6%	9,4%
<b>Total</b>	<b>115.698</b>	<b>325.874</b>		<b>67.107</b>	<b>48.591</b>	<b>58,0%</b>	<b>42,0%</b>

Tab. 10: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (mujore)

Sipërfaqeve të mirëmbajtura	Euro	%
AN-Ambienti i ndërtuar	73.385	63,4%
AP-Aktivitetet e pastrimit	25.243	21,8%
H-Aktivitetet e hortikulturës	17.070	14,8%
<b>Totali</b>	<b>115.698</b>	<b>100,0%</b>

Tab. 11: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (muajore)

Sipërfaqeve të mirëmbajtura	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Totali
AN-Ambienti i ndërtuar	5.664	5.664	7.803	6.041	6.052	6.047	6.052	6.047	6.052	5.981	6.452	5.530	73.385
AP-Aktivitetet e pastrimit	-	1.424	3.785	2.900	2.937	3.317	3.334	3.317	2.968	1.262	-	-	25.243
H-Aktivitetet e hortikulturës	27	27	14.798	185	185	252	194	220	319	582	105	177	17.070
Totali	5.691	7.114	26.386	9.127	9.174	9.615	9.580	9.584	9.339	7.825	6.557	5.707	115.698
Në %	4,9%	6,1%	22,8%	7,9%	7,9%	8,3%	8,3%	8,3%	8,1%	6,8%	5,7%	4,9%	100,0%

Tab. 12: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (tremujore)

Kategoria	TM1/2016	TM2/2016	M3/2016	M4/2016	Totali	%
AN-Ambienti i ndërtuar	19.131	18.140	18.151	17.963	73.385	63,4%
AP-Aktivitetet e pastrimit	5.208	9.154	9.619	1.262	25.243	21,8%
H-Aktivitetet e hortikulturës	14.852	622	733	864	17.070	14,8%
Totali	39.191	27.916	28.502	20.089	115.698	100,0%
Në %	33,9%	24,1%	24,6%	17,4%	100,0%	

Tab. 13: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (gjysmë-vjetore)

Kategoria	Jan.-qersh./2016	Korik-dhjetor/2016	Totali	%
AN-Ambienti i ndërtuar	37.271	36.113	73.385	63,4%
AP-Aktivitetet e pastrimit	14.362	10.881	25.243	21,8%
H-Aktivitetet e hortikulturës	15.474	1.597	17.070	14,8%
Totali	67.107	48.591	115.698	100,0%
Në %	58,0%	42,0%	100,0%	




Fig. 7: Kostot e mirëmbajtjes në bazë të kategorive

Tab. 14: Mirëmbajtja ne baze kategorive kryesore (e shprehur ne vlere)

Kategoria	Shesh	Park	Parking	Fusha Sportive	Trotuare	Treg	Varreza	Totali	%
AN-Ambientnd.	5,942	23,349	15,863	3,972	17,107	3,199	3,952	73,385	63%
AP-Akt. e Pas-trimit	50	17,051	207	683	3,428	30	3,795	25,243	22%
H-Aktivitetet e Hortikulturës	270	3,127	6,590	454	5,703	927	-	17,070	15%
Total	6,262	43,527	22,660	5,109	26,237	4,156	7,747	115,698	100%
Ne %	5.4%	37.6%	19.6%	4.4%	22.7%	3.6%	6.7%	100.0%	

Tab. 15: Mirëmbajtja ne baze kategorive kryesore(Sipërfaqet e përllogaritura)

Kategoria	Shesh	Park	Parking	Fusha Sportive	Trotuare	Treg	Varreza	Total	%
AN-Ambienti i ndërtuar	7,156	32,857	25,594	11,495	28,800	10,156	32,936	148,995	46%
AP-Aktivitetet e Pastrimit	-	105,440	710	3,700	-	-	65,872	175,722	54%
H-Aktivitetet e Hortikulturës	-	150	633	50	274	51	-	1,157	0%
H-Aktivitetet e Hortikulturës	7,156	138,447	26,937	15,245	29,074	10,207	98,808	325,874	100%
Ne %	2.2%	42.5%	8.3%	4.7%	8.9%	3.1%	30.3%	100.0%	

Tab. 16: Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (Vlera e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të përllogaritura)

Kategoria	Vlera	Vlera në %	m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup> %
Parqe	43.527	37,6%	138.447	42,5%
Trotuare	26.237	22,7%	29.074	8,9%
Parkingje	22.660	19,6%	26.937	8,3%
Varreza	7.747	6,7%	98.808	30,3%
Sheshe	6.262	5,4%	7.156	2,2%
Fusha sportive	5.109	4,4%	15.245	4,7%
Tregje	4.156	3,6%	10.207	3,1%
Totali	115.698	100,0%	325.874	100,0%



Fig. 8: Vlera e mirëmbajtës vjetore

Rrjedha e parasë (cash flow ) e kostove të mirëmbajtjes së përllogaritjes së sezonit të kostove

Tab. 17: Kostot vjetore të mirëmbajtës së HHP-ve, e bazuar në muaj

Kategoria	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Totali
Kostot vjetore të mirëmbajtjes	5.691	7.114	26.386	9.127	9.174	9.615	9.580	9.584	9.339	7.825	6.557	5.707	115.698
Në %	4,9%	6,1%	22,8%	7,9%	7,9%	8,3%	8,3%	8,3%	8,1%	6,8%	5,7%	4,9%	100,0%



Fig. 9: Kostot vjetore të mirëmbajtjes

Tab. 18: Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve (mujore)

Kategoria	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Total	Ne %
Sheshe	143	193	962	600	600	600	600	600	610	600	612	143	6.262	5,4%
Parqe	536	1.071	9.574	4.290	4.435	4.490	4.457	4.430	4.461	3.125	2.120	536	43.527	37,6%
Parkingje	1.342	1.392	7.082	1.405	1.404	1.410	1.409	1.439	1.486	1.381	1.550	1.358	22.660	19,6%
Terrene sportive	290	325	1.152	376	413	413	413	413	415	376	230	290	5.109	4,4%
Trotuare	2.644	3.195	6.570	1.264	1.460	1.510	1.510	1.510	1.497	1.023	1.411	2.644	26.237	22,1%
Tregje	406	436	717	203	203	203	203	203	210	660	305	406	4.156	3,6%
Varreza	329	501	329	988	659	988	988	988	659	659	329	329	7.747	6,7%
